

Shqipëria: sfidat e mërgimit në Ballkan

Kalimi transit, emigracioni,
riatdhesimi i detyruar:
qarkullim i penguar i qytetarëve

Raport

Raport

Shqipëria:
sfidat e mërgimit
në Ballkan

1

La Cimade

Hyrje

Në bisedime për integrimin e saj në Bashkimin Europian (BE), Shqipëria është një nga vendet ende jo-anëtare ku po eksperimentohet bashkëpunimi me BE-në, veçanërisht për çështjet e emigracionit. Shqipëria, është në të njëjtën kohë vend transit për mërgimtarët e huaj që përshkuajnë territorin e saj kalimthi, për shqiptarët dhe shqiptaret është vendi nga ku shtetasit e saj emigrojnë drejt botës, veçanërisht drejt BE-së, si dhe një vend që riatdheson qytetarët dhe qytetaret e saj të dëbuar nga territori europian, veçanërisht nga Franca.

2

Ky raport propozon një ndihmesë në kuptimin e rolit të Shqipërisë në këtë aspekt të dyfishtë: nga njëra anë situata e mërgimtarëve të huaj që ndodhen në transit në këtë vend, dhe nga ana tjetër dëbimi i shtetasve shqiptarë nga Franca me anën e agjencisë europiane të mbrojtjes bregdetare dhe kufitare, Frontex.

Informacionet e mbledhura për këtë raport janë përfituar falë konstatimeve të kryera nga një mision i disa përfaqësueve të shoqatës franceze në ndihmë të emigrantëve, “La Cimade” (shqiptimi: La Simad), i organizuar në Shqipëri gjatë muajit qershor 2022, si dhe falë punës kërkimore të kryer para këtij misioni.

BE-Shqipëri: një bashkëpunim i hershëm

Dialogu midis shteteve anëtare europiane dhe Shqipërisë për aderimin e saj në BE është çelur në fillim të viteve 2000. Ky proces bashkëpunimi, i cili vazhdon që prej më shumë se 20 vitesh, ka një ndikim të veçantë në trajtimin e çështjeve të emigracionit si dhe në politikat kombëtare të vendit.

1. Olivier Peyroux, «Que cachent les demandes d'asile en provenance d'Albanie?», in *L'asile en France et en Europe*, Forum réfugiés COSI, 2020.

2. Dott. Agim Leka, «Albanian migration during the post communist transition and the European integration in global era: An intercultural reflection», in *Academicus, International Scientific Journal*, 2013.

3. Olivier Peyroux, *op. cit.*

Shqipëria: Bashkimin European për perspektivë

Shqipëria, e ndodhur në perëndim të gadishullit të Ballkanit, izolohet nga diktatura komuniste e Enver Hoxhës gjatë viteve 1945-1985. Gjatë kësaj periudhe shqiptarët dhe shqiptaret e kanë të ndaluar të udhëtojnë apo të jetojnë jashtë shtetit. Sipas kërkuesit Olivier Peyroux,¹ kjo e kaluar e bazuar te izolimi, si dhe tensionet sociale dhe ekonomike të krijuara pas rënies së regjimit komunist në vitin 1991, shpjegojnë veçantinë e emigracionit shqiptar. Gjatë viteve 1990 disa eksode të njëpasnjëshme të shqiptarëve kanë lënë gjurmë të pashlyera në shoqërinë e këtij vendi. Eksodi i parë me drejtim veçanërisht në shtetet Itali dhe Greqi, midis viteve 1990 dhe 1993, erdhi si pasojë e rënies së regjimit komunist. Midis muajve mars dhe qershor 1991, më tepër se 50 000 persona lanë vendin e tyre për të shkuar drejt Italisë.² Në vitin 1997, sistemi financiar shqiptar shembet duke rrënuar ekonominë e mijëra familjeve shqiptare, ngjarje të cilat provokuan një tjetër eksod. Në vitin 2001, 500 000 shqiptarë e shqiptare braktisën vendin e tyre për të jetuar në Greqi dhe 270 000 në Itali.³

Në vitin 2003 Shqipëria njihet si vend i mundshëm kandidat për aderim në Bashkimin Europian gjatë konferencës së kryetarëve të shteteve BE - Ballkan perëndimor në Selanik. Në 2006-ën nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) shënon etapën e parë në këtë proces. Në bazë të kësaj marrëveshjeje u vendos midis të tjerave përafrimi i legjislacionit në disa fusha, si dhe bashkëpunimi veçanërisht në drejtësi dhe në çështjet e brendshme, duke përfshirë administrimin e emigracionit, të azilit politik, si dhe kontrollin e kufijve. Ndonëse Shqipëria kërkoi statusin e vendit kandidat në BE që në vitin 2009, ky shtet e siguroi këtë status zyrtarisht vetëm në vitin 2014. Pas tri refuzimeve në vitet 2016, 2018 dhe 2019 (me veto të Francës) Këshilli i BE-së nënshkroi përfundimisht në mars 2022 marrëveshjen për çeljen e bisedimeve për aderim në BE të Shqipërisë, bisedime që nisën zyrtarisht në korrik 2022.

Një laborator i kontrolleve të emigracionit të BE-së në Ballkan

Në kuadrin e këtij procesi aderimi,

Shqipëria duhet t'i përshtatet "*Acquis communautaire*" apo normave të BE-së, përkufizuar nga Komisioni Europian si "baza e përbashkët e të drejtave dhe e detyrimeve që lidh të gjitha shtetet anëtare me Bashkimin Europian." Kjo tërësi normash mbulon disa fusha si politika e jashtme dhe e sigurisë, bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në lëndë penale, etj. Ky detyrim i përafrimit të legjislacionit me normat e BE-së ndikon në politikën e emigracionit të vendeve anëtare dhe vendeve në proces aderimi. Shqipëria veçanërisht ka përafruar legjislacionin e saj në fushat si politika e vizave, kontrolli i kufijve, sistemi i azilit politik, lëshimi i lejeve të qëndrimit, si dhe politikat e dëbimit dhe të riatdhesimit.

Në prill të vitit 2005 Shqipëria ka qenë vendi i parë në Ballkan që nënshkroi një marrëveshje të Ripranimit me bashkësinë e shteteve anëtare të BE-së. Sipas kësaj marrëveshjeje vendi ishte i detyruar tashmë të riatdhesonte shtetasit e saj të gjendur në situatë të parregullt administrative në territorin e BE-së, por edhe të ripranonte gjithë shtetasit jo-europianë të cilët kishin hyrë në mënyrë të parregullt në BE, pas një qëndrimi të mundshëm apo kalimi transit nga Shqipëria. Më tej Shqipëria ka nënshkruar disa protokolle marrëveshjeje shtesë me 12 shtetet anëtare të BE-së për zbatimin praktik të dëbimeve.

Që me nënshkrimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit në 2006-ën, Shqipëria ka hequr vizat e hyrjes në territorin e saj për qytetarët dhe qytetaret e BE-së. Paralelisht me këtë BE ka nxitur me forcë Shqipërinë të vendosë regjimin e vizave për shtetasit e disa vendeve të tjera (si Armenia, Azerbajxhani, Biellorusia, Kina, Gujana, Kazakistani, Kuvaiti dhe Turqia). Por deri më sot Komisioni europian mbetet i pakënaqur për këtë çështje. Në raportin e tij të fundit vjetor për Shqipërinë (2022) Komisioni kujton se "politika e vizave të Shqipërisë ende nuk është plotësisht e përshtatur me politikën e vizave të BE-së, në lidhje me listën e vendeve, shtetasit e të cilëve kanë nevojë për vizë hyrjeje".⁴

4. Komisioni europian, Raport mbi Shqipërinë 2022, tetor 2022.

5. Siti i internetit i Komisionit europian, Accession of Western Balkan countries.

6. Sophie-Anne Bisiaux, Lorenz Naegeli, "Chantage dans les Balkans: comment l'UE externalise ses politiques d'asile", Migreurop, nëntor 2021.

Në vitin 2010, BE-ja dhe Shqipëria nënshkruan marrëveshjen për liberalizimin e vizave për shqiptarët dhe shqiptaret. Marrëveshja u mundësoi shtetasve shqiptarë të qëndrojnë në hapësirën Shengen pa patur nevojë për vizë, për 90 ditë, me kusht që të jenë të pajisur me një pasaportë biometrike. BE ka vënë në zbatim një mekanizëm për mbarëvajtjen e këtij procesi të liberalizimit të vizave, i cili parashikon mundësinë për Komisionin europian të pezullojë këtë të drejtë udhëtimi pa viza nëse e çmon të nevojshme. Për këtë mekanizëm Komisioni justifikohet: "edhe pse shumica dërrmuese e qytetarëve të vendeve të përjashtuara nga regjimi i vizave në Ballkanin perëndimor janë udhëtarë që qarkullojnë në BE në mirëbesim të plotë dhe për arsye të drejta, Komisioni mbikqyr rregullisht respektimin e kërkesave të liberalizimit të vizave dhe masat e ndërmarra nga vendet përkatëse, në mënyrë që të ruhet progresi i arritur dhe me qëllim që abuzimet e mundshme ndaj marrëveshjes për liberalizimin e vizave të trajtohen në mënyrë të frytshme".⁵ Kjo situatë nxit një politikë vizash të kushtëzuar nga politika e dëbimit për shtetasit shqiptarë, qarkullimi i të cilëve në BE nuk çmohet si "i ligjshëm". Për më tepër BE-ja inkurajon Shqipërinë — por edhe të gjithë vendet e tjera të ndodhura në rrugën e Ballkanit — të krijojë një sistem të mbledhjes së të dhënave biometrike të emigrantëve. Sistemet e informacionit të zhvilluara me mbështetjen teknike të agjencive europiane (Europol, Frontex) për të mbledhur këto të dhëna kanë marrë si model bazën e të dhënave të BE-së në pritje të ndërlikjes së tyre të ardhshme.⁶

Paralelisht me politikën "viza në këmbim të dëbimit", bashkëpunimi në fushën e kontrollit të kufijve duket si një kusht veçanërisht vendimtar në bisedimet për aderim me vendet anëtare të BE-së, të cilët përpiqen të kufizojnë ardhjet e emigrantëve të huaj në territorin e tyre. Për këtë arsye Shqipëria, që prej vitit 2019, është vendi i parë jo-europian i cili ka ndërmarrë një operacion të përbashkët me agjencinë Frontex në kufijtë e saj. Edhe pse përbën një përparësi për BE-në, sot për sot kontrolli i kufijve dhe i emigracionit transit nuk duket të jetë një përparësi për autoritetet shqiptare. Sipas disa përfaqësuesve që takuam gjatë misionit tonë, Shqipëria ndodhet sot përballë sfidave të tjera ekonomike dhe sociale, si sfida e emigracionit të popullatës së saj jashtë shtetit. Në këtë kontekst Shqipëria, si vend për të cilin çështjet e vizave dhe të dëbimeve kanë një ndikim të rëndësishëm, nuk ka tjetër rrugë veç të tregojë vullnetin e saj të mirë.

BE-Shqipëri një bashkëpunim i hershëm

1992	Nënshkrim i një marrëveshjeje bashkëpunimi dhe tregtie midis Bashkimit evropian dhe Shqipërisë.
Qershor 2000	Konferencë e kryetarëve të shteteve në Santa Maria da Feira - Dialogu i parë zyrtar midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit me qëllimin e një kandidature të mundshme për aderim.
Nëntor 2000	Konferencë e kryetarëve të shteteve BE-Balkan në Zagreb: Shqipëria dhe BE-ja nënshkruajnë fillimin e procesit të Stabilizim Asociimit (PSA) i cili ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal.
Prill 2005	Nënshkrim i marrëveshjes së ripranimit BE-Shqipëri: Shqipëria është vendi i parë në Ballkan që firmos një marrëveshje ripranimi me BE-në, sipas të cilës vendi është i detyruar të ripranojë të gjithë shtetasit e saj shqiptarë të ndodhur në situatë të parregullt në territorin e BE-së, por edhe shtetasit e vendeve të tjera të ndodhur ilegalisht në BE pas një qëndrimi apo kalimi transit nga Shqipëria.
Qershor 2006	Nënshkrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në. Shqipëria angazhohet veçanërisht për të bashkëpunuar në fushën e vizave, të azilit politik dhe në luftën kundër emigracionit të quajtur "të parregullt".
Prill 2007	Marrëveshje me qëllim lehtësimin e lëshimit të vizave të qëndrimit afatshkurtër midis Komunitetit evropian dhe Shqipërisë.
2009	Shqipëria kërkon statusin e vendit kandidat për anëtar në BE — vendi pëson një refuzim.
Nëntor 2010	Nënshkrim i marrëveshjes për liberalizimin e vizave për të gjithë shqiptarët dhe shqiptaret.
2014	Franca bashkëpunon me Shqipërinë për organizimin e CRO (anglisht – collecting return operations) operacion i grumbullimit dhe largimit të shtetasve për riatdhesim) nën patronazhin e agjencisë Frontex.
Qershor 2014	Këshilli i Europës i jep Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtar në BE.
2016	Refuzimi i parë i këshillit të Bashkimit Evropian për çeljen e bisedimeve për aderim me Shqipërinë, sipas të cilit vendi duhet të vijojë me reformat e sistemeve të tij administrativ e gjyqësor, të vazhdojë luftën kundër krimit të organizuar, si dhe të shtojë përpjekjet në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut e politikave kundër diskriminimit ndaj minoriteteve.
2018	Refuzimi i dytë i këshillit të Bashkimit Evropian për çeljen e bisedimeve për aderim me Shqipërinë, sipas të cilit vihen në dukje problemet e vazhdueshme të korrupsionit, të krimit të organizuar dhe të paqëndrueshmërisë politike në vend.
Tetor 2018	Nënshkrim i marrëveshjes së statutit të bashkëpunimit në lidhje me kontrollin e kufijve midis BE-së dhe Shqipërisë dhe në lidhje me veprimet e ndërmarra nga agjencia Frontex në territorin shqiptar.
2019	Refuzimi i tretë i për çeljen e bisedimeve për aderim me Shqipërinë. Franca, Holanda, Danimarka dhe Spanja shprehen kundër, duke çmuar si të pamjaftueshme garancitë e vendit në respektimin e kritereve europiane e veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
Maj 2019	Shqipëria është vendi i parë jo-anëtar në BE që ndërmerr një operacion të përbashkët me agjencinë Frontex në territorin e saj.
Korrik 2022	Këshilli i BE-së çel zyrtarisht bisedimet për aderim me Shqipërinë.

Gjendja e mërgimtarëve të huaj në transit në Shqipëri

Gjatë udhëtimit të tyre, mërgimtarët e huaj të ardhur kryesisht nga Turqia dhe Greqia, përshkojnë Shqipërinë për të vijuar rrugëtimin e tyre drejt veriut të Ballkanit.

7. Takim me UNHCR, 20 qershor 2022.

Filtrimi në kufij: procedura e para-identifikimit

Sipas Komisariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), 82 % e mërgimtarëve të huaj në transit në Shqipëri deklarojnë se janë me origjinë nga vendet *"me përqindje të lartë të dhënies së mbrojtjes ndërkombëtare apo azilit politik"*, vende nga Lindja e Afërt dhe Lindja e Mesme, si Siria, Iraku, Afganistani apo Palestina.⁷ Por ka gjithashtu edhe shtetas të vendeve të Afrikës veriore kryesisht nga Algjeria dhe Maroku dhe në një numër më të vogël persona me origjinë nga Bangladeshi, Pakistani dhe India.

Mërgimtarët në transit në Shqipëri, të ndaluar nga rojet kufitare shqiptare dhe europiane, si në hyrje të vendit në kufirin jugor me Greqinë, por dhe në dalje, në kufirin verior me Malin e Zi dhe Kosovën, i nënshtrohen një procedure të quajtur të para-identifikimit, të kryer në disa qendra të posaçme të ndodhura në afërsi të kufijve. Këto qendra të administruara nga autoritetet shqiptare janë në varësi të ministrisë së Brendshme shqiptare. Në këto qendra, përveç rojeve

kuftare shqiptare veprojnë gjithashtu edhe përfaqësues të Frontex-it apo të Caritas-it. Gjatë marrjes në pyetje, mërgimtarët foto-grafohen, si dhe u merren shenjat e gishtrinjëve. Ata u përgjigjen një sërë pyetjeve të një formulari ku kërkohet veçanërisht kombësia, besimi fetar, profesioni, rrugëtimi i tyre dhe vendi i arrestimit. Disa skenarë janë të mundshëm në përmbyllje të kësaj procedure:

Në rast se personi shpreh vullnetin për të kërkuar azil politik dhe në rast se autoritetet shqiptare e pranojnë këtë kërkesë, mërgimtari dërgohet drejt Qendrës kombëtare të pranimit së azilkerkuesve në Babrru, Tiranë. Drejtoria për azilin dhe migracionin pranë ministrisë së Brendshme shqiptare çmon se praktikisht “90 % e personave që shoqërohen në qendrën e Babrrusë arratisen brenda 24 orëve”⁸ me qëllim për të vijuar me rrugëtimin e tyre.

Nëse mërgimtari nuk kërkon azil apo kërkesa e tij e azilit nuk regjistrohet nga autoritetet shqiptare, mbeten dy mundësi:

- Personi nuk i nënshtrohet ndalimit administrativ (mbylles në një qendër) por i bëhet me dije një urdhër për t’u larguar me vullnetin e tij nga territori shqiptar në një afat nga 7 deri në 14-ditor.
- Personi shoqërohet në qendrën e ndalimit administrativ për personat me origjinë të huaj të ndodhur në qytetin e Karreçit. Arsyet e dërgimit drejt kësaj qendre mbeten të paqarta dhe ndryshojnë sipas bashkëbiseduesve të pyetur (Mekanizmi kombëtar shqiptar i parandalimit të torturës (MNP) dhe ministria e Brendshme shqiptare). Ndalimi administrativ apo mbyllja në qendër ndërmerret sipas gjasave ndaj personave të konsideruar të rrezikshëm nga

8. Takim me drejtorinë për azilin dhe migracionin të ministrisë Brendshme shqiptare, 29 qershor 2022.

8



Tabelë të rruga përballë kishës katolike ku vepron Atë Anxhelo, në Beltojë, qarku i Shkodrës. Gjatë misionit tonë në qershor 2022, patëm mundësinë të vëzhgojmë praninë e disa vendprijtjeve solidare me mërgimtarët e huaj, si kjo kishë që ofron një vend pushimi për personat e huaj në transit drejt veriut të vendit.

© La Cimade

Roli kyç i Mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës

Mekanizmi kombëtar i parandalimit të torturës, të dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore apo degraduese (MNP) vepron pranë Avokatit të Popullit, autoriteti administrativ shqiptar i ngarkuar për të mbikqyrur respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. MNP ka për mision të kontrollojë respektimin e të drejtave të njeriut në të gjitha

institucionet ku liritë individuale janë të kufizuara, veçanërisht: zyrat e policisë, burgjet dhe qendrat e ndalimit, ushtria, spitalet, por edhe pikat e kalimit kufitar e qendrat që strehojnë emigrantët apo viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore. Në këtë mënyrë MNP ka në ngarkim mbikqyrjen e qendrës së ndalimit të personave me origjinë të huaj në Karreç, qendrat e regjistrimit dhe të strehimit të përkohshëm në kufij, si dhe fluturimet Frontex me qëllim dëbimin e shtetasve shqiptarë nga BE-ja. Është i vetmi institucion që ka mundësinë të vizitojë të gjitha qendrat kurdoherë.

9. Ligji n° 10 195 i publikuar në Fletoren Zyrtare shqiptare të datës 10 dhjetor 2009, n° 194.

10. Komisioni europian, Raport për Shqipërinë 2022, tetor 2022.


autoritetet shqiptare, apo ndaj personave që nuk dëshirojnë të kërkojnë azil, të kthehen në Greqi, apo thjesht për personat që janë ndaluar për kalim të parregullt të kufirit.


Në rastet kur personat nuk ndalohen apo nuk dërgohen nga autoritetet në qendrën e Karreçit, në shumicën e rasteve, ata vijnë udhëtimin e tyre drejt veriut të Shqipërisë, deri në qarkun e Shkodrës në kufi me Malin e Zi dhe Kosovën. Mërgimtarë të tjerë përpiqen të kalojnë kufirin në rrugë detare në perëndim të vendit. Gjatë periudhës së këtij misioni të “La Cimate” ishin hapur në Tiranë, Beltojë, Durrës dhe Hot disa vendprijtje solidare ku mërgimtarët mund të pushojnë dhe të marrin një ndihmë të parë mjekësore. Këto qendra administrohen nga persona fetarë, të cilët kanë hapur kishat dhe xhamitë e tyre, ose nga militantë të të drejtave të emigrantëve.


Kontrolli i emigracionit në kufijtë e saj e ka nxitur Shqipërinë të nënshkruajë një marrëveshje ripranimi me Malin e Zi në vitin 2009.⁹ Në këtë kuadër, dëbimet e mërgimtarëve të huaj nga Mali i Zi për në Shqipëri janë të mundura nëse rojet kufitare malazeze paraqesin një provë të kalimit të personit të ndaluar në territorin shqiptar (për shembull një vizë, ose një urdhër largimi nga territori shqiptar). Në terren policia e kufirit në Shkodër shpjegon se kur kjo provë nuk ekziston, oficerët e të dy anëve të kufirit diskutojnë për të vendosur cili nga dy vendet do të pranojë personin e huaj në territorin përkatës. Për më tepër Shqipëria kërkon të nënshkruajë një marrëveshje ripranimi për të lehtësuar procedurën e kthimit drejt Greqisë të mërgimtarëve të ndaluar në kufirin e saj jugor. Propozimi i marrëveshjes i hartuar nga autoritetet shqiptare mbetet dhe sot e kësaj dite pa përgjigje.¹⁰


Kalimi transit dhe ndalimi administrativ në Shqipëri

10



 Qendrat e regjistrimit dhe të strehimit të përkohshëm

 Qendra kombëtare për azilërkuesit në Babrru

 Qendra e ndalimit administrativ për personat e huaj në Karreç

 Operacionet Frontex në Shqipëri

Fokus mbi qendrat për personat e huaj

Qendrat e regjistrimit dhe të strehimit të përkohshëm të të huajve ndodhen në afërsi të kufijve. Në jug, në kufi me Greqinë, njëra prej qendrave ndodhet në Kapshticë, afër qytetit të Korçës dhe ka një kapacitet prej 110 vendesh. Qendra e dytë ndodhet në Gerhot afër Gjirokastrës, me një kapacitet prej 60 vendesh. Në veri të vendit, në kufi me Malin e Zi gjendet qendra e tretë, Fshati i paqes në Shkodër.

Nëse një person ndalohej pa dokumenta të rregullta në kufi, ai shoqërohet nga policia në një nga qendrat, në pritje për t'u marrë në pyetje nga policia kufitare, zyrat e të cilës ndodhen në afërsi të kufijve.

Qendra kombëtare për azilkërkuesit e huaj në Babrru (në periferi të Tiranës) Kjo qendër është çelur në 2014-ën falë një financimi të Bashkimit Europian. Kapaciteti është rritur nga 180 në 250 vende. Kjo qendër paraqitet si një

vendstrehim "i hapur" ku personat janë të lirë të qarkullojnë sipas vullnetit të tyre. Por në realitet qendra e Babrrusë është e rrethuar dhe e mbyllur me një portë me çelës, si dhe e ruajtur nga një agjent sigurimi i vendosur në hyrje. Gjithash-tu edhe hyrja në qendër për personat e jashtëm duket e kufizuar.

Qendra e ndalimit për personat e huaj në Karreç (afër Durrësit)

Në afërsi me qytetin e Durrësit, qendra është çelur në 2009-ën dhe ka një kapacitet prej 100 vendesh të ndara në 25 dhoma. Të huajt mund të mbahen të ndaluar në Karreç me urdhër të autoriteteve shqiptare për një afat maksimal 6-mujor, afat që në disa raste mund të zgjatet për një periudhë maksimale 12-mujore. Përfaqësuesit e Mekanizmit kombëtar shqiptar për parandalimin e torturës, dënimeve dhe trajtimeve mizore, çnjerëzore apo degraduese (MNP) nënvizojnë mungesën e një mjeku, të punonjësve socialë, të edukatorëve dhe të përkthyesve në këtë qendër. Ndërtesa është e vjetër dhe janë vënë re shumë mangësi.

11. Mary Ward Loreto Foundation, "The Albanian National Reception Centre for Refugees: Babrru near Tirana", tetor 2015.

2020: Ndërprerje e procedurës së kërkesës së azilit në kufij

Këto vitet e fundit

Shqipëria ka bashkëpunuar ngushtë me BE-në dhe UNHCR-në për të përfaruar dhe përshtatur politikën e saj të azilit me normat e BE-së (me *acquis communautaire*). Pikërisht ligji i ri për azilin, i miratuar në tetor të vitit 2021, i cili ka zëvendësuar ligjin e mëparshëm të votuar në 2014-ën, është fryt i këtij bashkëpunimi. Sa i përket infrastrukturës, Qendra kombëtare e pranimit së azilkërkuesve është çelur në 2014-ën në Babrru, në periferi të Tiranës, me një financim të BE-së.¹¹ Në vitin 2021 ndërtesa e kësaj qendre u meremetua dhe kapaciteti i saj u rrit nga 189 në 250 vende. Por megjithatë që prej vitit 2020 shumë pak azilkërkues janë strehuar në këtë qendër. Gjatë vizitës sonë në qendër, në qershor 2022, vetëm 17 persona ishin të strehuar. Duke filluar nga muaji qershor 2020, praktikantët e autoriteteve

12. Takim me UNHCR, 20 qershor 2022.

13. Takim me delegacionin e BE-së, 21 qershor 2022.

14. Avokati Popullit, Raporti vjetor në lidhje me aktivitetin e Avokatit të Popullit, 2021.


shqiptare në lidhje me regjistrimin e kërkesave të azilit duket se kanë ndryshuar. Gjatë të njëjtit vit UNHCR ka vërejtur një rënie të numrit të kërkesave të azilit të regjistruara nga policia shqiptare. Edhe pse mund të mendonim se kjo rënie ka qenë e përkohshme për shkak të pandemisë së Kovid-19, del qartë se 99 % e kërkesave të azilit në 2020-ën janë regjistruar para mbylljes së kufijve në mars, ndërkohë që pas rihapjes së kufijve në qershor e deri në fund të vitit nuk është shënuar asnjë kërkesë për azil.¹² UNHCR nënvizon se ka vërejtur disa parregullsi gjatë procedurës së para-identifikimit në kufij. Rojet kufitare nuk i pyesnin më sistematikisht mërgimtarët e huaj në lidhje me nevojën e tyre për mbrojtje ndërkombëtare dhe as për dëshirën e tyre për të kërkuar azil. Delegacioni i BE-së në Tiranë ka ndarë me ne këto vërejtje: *“Kemi dyshime nëse autoritetet shqiptare i pyesin realisht apo jo personat e ndaluar në kufirin me Greqinë nëse dëshirojnë të kërkojnë azil politik në Shqipëri, pyetje që duhet bërë normalisht nga autoritetet. Ne mendojmë që kjo pyetje nuk u drejtohet më mërgimtarëve.”*¹³ Refugee and Migrant Services in Albania (RMSA) (në shqip: Shërbimi për Refugjatët dhe Mërgimtarët në Shqipëri) nga ana e tij ka konstatuar disa formularë të plotësuar gabim ku kutitë me shënimet “po” dhe “jo” janë të dyja të plotësuar apo të përzgjedhura njëkohësisht. Në kuadrin e misionit të saj, “La Cimade” pati mundësinë të shqyrtonte formularin e para-identifikimit të përdorur në atë periudhë: në dokumentin e paraqitur nuk kishte asnjë shënim në lidhje me mbrojtjen ndërkombëtare apo azilin. Në raportin e tij vjetor për Shqipërinë, të publikuar në tetor 2022, Komisioni europian pohon se “orientimet drejt procedurës së azilit nuk zbatohen nga autoritetet” dhe shpreh nevojën e rihapjes së rrugës drejt procedurës së azilit.

MNP në raportin e tij për aktivitetin e vitit 2021 përmend: *“domosdoshmërinë për të përmirësuar procedurën e pyetje-përgjigjeve të para-identifikimit [...] duke i dhënë më tepër hapësirë nevojës së mundshme për mbrojtje ndërkombëtare”*.¹⁴ Pavarësisht përpjekjeve për t’iu përgjigjur kërkesave të BE-së, e cila kërkon një kontroll më të fortë të kufijve, me sa duket autoritetet shqiptare nuk kanë shfaqur vullnet konkret për t’u krijuar mundësinë mërgimtarëve të huaj të kërkojnë azil apo të jetojnë në Shqipëri. MNP vë në dukje, po në raportin e përmendur më sipër, se kërkesat e azilit janë pakësuar edhe për shkak të “përpjekjeve të ndërmarra nga autoritetet shqiptare për të penguar këtë tendencë të emigrantëve të parregullt që përdorin Shqipërinë si vend kalimi transit drejt Europës perëndimore”.

12

Evolucioni i kërkesave të azilit në Shqipëri (2015-2021)

Burimi Raportet vjetore të Komisionit European mbi Shqipërinë.



Shqiptarët dhe shqiptaret shënjestër e makinerisë së dëbimit nga BE-ja

Shqipëria, sipas Eurostat, është vendi me numër më të madh të shtetasve të saj të dëbuar nga shtetet anëtare europiane. Në Francë në vitin 2021, 45% e dëbimeve jashtë BE-së u realizuan drejt Shqipërisë, e cila renditet e para për nga numri i shtetasve të saj të ndaluar dhe të dëbuar nga BE. Dëbimet kryhen gjithmonë e më shpesh me anën e fluturimeve europiane të posaçme me avionë çarter nën patronazhin e agjencisë europiane Frontex.

Fluturimet çarter të Frontex: instrumenti i përzgjedhur për dëbim drejt Shqipërisë

Midis shërbimeve të ndryshme të propozuara nga Frontex ndaj shteteve anëtare, operacionet e quajtur "me grumbullim" duket se janë përzgjedhur për të kryer dëbimet drejt vendeve të Ballkanit perëndimor, ndër të cilët renditet e para Shqipëria. Veçantia e këtyre operacioneve është angazhimi direkt i autoriteteve të vendeve të origjinës, të cilët paraqiten me përfaqësuesit e tyre policorë për të "mbledhur ose grumbulluar" e për të dërguar në atdhe shtetasit e tyre të dëbuar nga një apo disa vende anëtare të BE-së. Sipas delagacionit të BE-së, në kontekstin e bisedimeve për aderim me BE-në "autoritetet shqiptare

janë mjaft të hapura për të bashkëpunuar me tërësinë e agjencive të BE-së, Frontex apo institucione të tjera" dhe BE do të dëshironte t'a zhvillonte më tej këtë "model bashkëpunimi [...] në Ballkan, por dhe më gjerë".¹⁵ Kjo praktikë u mundëson shteteve europiane të përfitojnë nga operacionet e Frontex-it me qëllim dëbimin nga territori i tyre i disa dhjetrave personave njëkohësisht me fluturim çarter të posaçëm, duke e transferuar gjerësisht zbatimin e dëbimeve drejt shteteve të origjinës apo shteteve transit, në logjikën e zhvendosjes jashtë kufijve të saj të kontrollit të emigracionit. Karakteristikë për këto operacione është se kryhen nën masa të rrepta sigurie, për të cilat disa përfaqësues dëshmojnë që janë në disproporcion me këtë detyrë dhe shoqëruar me një "numër mbresëlënës policësh, ndonjëherë të panevojshëm".¹⁶

15. Takim me delegacionin e BE-së, 21 qershor 2022.


16. Takim me Mekanizmin kombëtar të parandalimit (MNP), 30 qershor 2022.

14

"Avionët çarter, të martave": rutina e dëbimit të shqiptarëve nga Franca

Që prej vitit 2017 autoritetet franceze organizojnë me mbështetjen e Frontex-it një operacion dëbimi "me grumbullim" të përjavshëm me nisje nga qyteti i Lille në Francë. I organizuar çdo të martë, ky fluturim realizohet pothuajse në të gjitha rastet në bashkëpunim me Belgjikën. Një pjesë e madhe e emigrantëve udhëtarë ndalohen përgjatë zonës bregdetare të Calais në Francë në përpjekje për të mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar. Në këtë zonë kufitare, shqiptarët janë shënjestër e kontrolleve sistematike nga

Ndalimi administrativ në një qendër dhe dëbimi i shqiptarëve nga Franca nga 2015 në 2021




Burimi Qendrat dhe ambientet e ndalimit administrativ, Raportet e disa shoqatave nga 2015 në 2021.

Në 6 vjet, numri i shqiptarëve të dëbuar nga Franca ka rënë. Përkundrazi përqindja e personave të ndaluar në qendrat administrative të dëbuar realisht,

është rritur, pavarësisht pandemisë që në përgjithësi ka ngadalësuar procedurën e largimeve.

Fluturimet e dëbimit të Frontex-it, të organizuara nga Franca drejt Shqipërisë (2015-2021)

Burimi Shifra të dërguara nga Frontex pas një kërkesë për dokumentacion të bërë në gusht 2019 dhe në maj 2022 nga "La Cimade".



CRO (Anglisht:Collecting Return Operation): Operacion dëbimi "me grumbullim" gjatë të cilit autoritetet e vendeve të origjinës zhvendosen në një apo disa shtete anëtare të BE-së për "të mbledhur a grumbulluar" e riadhesuar vetë shtetasit e tyre



NRO (Anglisht: National return operation): Operacion dëbimi i organizuar vetëm nga një shtet anëtar



JRO (Anglisht: Joint Return operation): Operacion dëbimi i përbashkët i organizuar nga disa vende anëtare të BE-së



VDR (Anglisht:Voluntary return departure): Operacion riadhesimi "me vullnetin e vetë emigrantit për t'u kthyer" që Frontex mund të organizojë që prej rihartimit të fundit të rregullores së tij në vitin 2019

— Gjithsej persona të dëbuar

Sa është kostoja ?

Burimi Shifra të përfituara pas pas një kërkesë për dokumentacion të bërë ndaj Frontex në maj 2022.

	2019	2020	2021
Kosto gjithsej për autoritetet franceze	2 100 000 €	1 700 000 €	2 400 000 €
Kosto mesatare/fluturim për autoritetet franceze	62 107 €	47 444 €	49 628 €

Kjo tabelë paraqet vetëm shpenzimet e financuara nga autoritetet franceze. Shpenzimet e tjera janë financuar nga shtetet anëtare që bashkëpunojnë për kryerjen e këtyre fluturimeve të organizuara nga Franca (sipas operacioneve,

Belgjika, Luksemburgu, Hollada, Finlanda) si dhe Shqipëria (për fluturimet e dëbimit me grumbullim — CRO) dhe nga agjencia Frontex.

16

autoritetet. Pasi ndalohen këta persona zhvendosen në një qendër ndalimi ku presin procedurën e dëbimit. Në vitin 2021, 40 % e shtetasve shqiptarë janë rikthyer në vendin e tyre nga qendra e ndalimit të Coquelles, e cila prej disa vitesh ka marrë funksionin e “sallës së pritjes” të dëbimeve nga territori francez me anën e “avionëve charter Frontex, të të martave”. Një mekanizëm i vajuar mirë që vë në punë makinerinë e dëbimit nga territori, pavarësisht rrethanave, madje edhe në kulmin e pandemisë në 2020-ën, kohë kur këto fluturime janë organizuar me të njëjtin ritëm. Sipas raportit të publikuar në qershor 2021 të disa shoqatave franceze në lidhje me qendrat e ndalimit “ndalimi në këto qendra i personave shqiptarë duket se ilustron vullnetin e autoriteteve franceze për të shënjestruar disa kombësi, shtetet e të cilave pranojnë lehtësisht riatdhesimet duke mundësuar rritjen e numrit të personave të dëbuar jashtë territorit të BE-së, numër që ka qenë në rënie të lirë në vitin 2020”.

Me fjalët e të dëbuarëve

Dëshmitë e personave të dëbuar në bordin e këtyre avionëve charter të përjavshëm të Frontex-it tregojnë ndjesitë e tyre të padrejtësisë, të poshtërimit por edhe të traumave psikologjike të lidhura me ndalimin, mbylljen në qendër dhe dëbimin.

“Ndjej dhembje sepse e di që nuk kam qenë në situatë të parregullt, kisha të drejtë të qëndroja në hapësirën Shengen për 3 muaj.”¹⁷

“Ishte si një burg [...]. Trajtimi që u bëhet personave në qendrat franceze është çnjerëzor dhe jo gjithkush mund ta durojë këtë situatë. Këto dy javë mund të mbeten përgjithmonë në kujtesën time.”¹⁸

17. Takim me A, 20 qershor 2022.

18. Takim me A, 22 qershor 2022.

Operacioni Frontex i riadhesimit me grumbullim, organizuar nga Franca më 16 prill 2019

Burimi Raporti i mbikqyrjes së Frontex-it në lidhje me fluturimin e riadhesimit të datës 16 prill 2019, i dorëzuar pas një kërkesë për dokumentacion të adresuar Frontex-it në maj 2022 nga "La Cimade".

Kosto gjithsej e fluturimit

80 413 €

43 062,72 €
për Francën

170,85 €
për Belgjikën

35 330,81 €
për Finlandën

1 848,96 €
për Shqipërinë



42

persona të dëbuar
34 burra,
5 gra, 3 fëmijë
të moshave 4, 7 dhe 8 vjeç



37

shoqërues policorë
35 burra
2 gra



1

agjent kontrolli
i të drejtave
themelore (Avokati
i popullit shqiptar)



1

agjent
i Frontex-it



2

punonjës
shëndetësorë
1 mjek
1 psikolog

19. Takim me D, 28 qershor 2022.

20. Takim me D, 28 qershor 2022.

"Avioni ishte vetëm për dëbimin e personave shqiptarë. Nuk kishte në bord udhëtarë të tjerë. Ishte plot me njerëz [...]. Çdo person kishte nga një polic që e shoqëronte."¹⁹

"Këtej e tutje, sapo mbyll derën e shtëpisë, ndjej direkt ankthin e mbylljes brenda."²⁰

Dëbim nga BE-ja dhe ndalim për të udhëtuar jashtë Shqipërisë ?

21. Takim me C, 20 qershor 2022.

22. Takim me MNP, 30 qershor 2022.

Masa e dëbimit

nga territori europian shoqërohet me një masë ndalimi për t'u rikthyer në Europë, dubluar me një regjistrim në listën europiane të përjashtimit nga vendet e BE-së (lista SIS-Sistemi i informacionit Shengen) për një afat nga një deri në tre vjet.

“Nuk mund të pranoj të trajtohem si një kriminel [...]. Do të doja të udhëtoja me miqtë e mi gjetkë për pushime, në Itali, në Greqi, por nuk mund të shkoj më në Europë. Jam bërë ndryshe nga të tjerët, bëhen dallime me mua dhe ndihem keq që nuk trajtohem si gjithë të tjerët”.²¹

Përveç dëbimit nga BE-ja, disa persona duket se e kanë të ndaluar më tej të dalin jashtë territorit shqiptar, madje edhe për të shkuar drejt vendeve jo-anëtare në BE, si p.sh. në Maqedoni. Dy persona të dëbuar me të cilët “La Cimade” mundi të komunikojë kanë shpjeguar se u është refuzuar dalja nga territori shqiptar ndërkohë që dëshironin të shkonin në Maqedoni. Një praktikë arbitrare dhe e paligjshme e policisë kufitare shqiptare, në rastet kur dyshon një rrezik udhëtimit transit nga Maqedonia me synimin për të mbërritur në hapësirën Shengen.²²

18

Shmangia e dëbimeve: informim kundër projekteve të emigracionit të parregullt

23. IOM, Prezantim i projektit Shqipëri/ARISE ALL, 29 mars 2021.

Përtej mjeteve të përdorura për

të dëbuar nga territori i tyre shqiptarët dhe shqiptaret, Bashkimi europian dhe shtetet e saj anëtare janë angazhuar në marrjen e masave për të bindur popullatën shqiptare të mos ikin nga vendi i tyre. Ky është qëllimi i projektit “ARISE ALL”, i nisur në mars 2021, i zbatuar nga Organizata ndërkombëtare për migracionin (IOM) dhe i financuar nga Fondi për azilin, migracionin dhe integrimin (FAMI) i BE-së, por dhe nga disa shtete anëtare (Belgjika dhe Holanda). Konkretisht ky projekt paraqet disa fushata komunikimi dhe informimi të realizuara për të “ndikuar në ndryshimin e sjelljes së grupeve që paraqesin potencial të lartë për emigracion të parregullt”.²³ Me fjalë të tjera, të pengohet qarkullimi në BE dhe njëkohësisht emigrantët të mbahen larg territorit europian.

Konkluzion

Për nga pozicioni i saj gjeografik, strategjik për shtetet anëtare të BE-së, Shqipëria gjendet në mes të një detyrimi të dyfishtë evropian: të përmbajë e të refuzojë personat që dëshirojnë të nisen drejt Europës perëndimore, të cilët gjenden në transit në territorin e saj dhe të pranojë të bashkëpunojë aktivisht me politikën e dëbimit të BE-së (me pjesëmarrjen në organizimin e fluturimeve të dëbimit të kryera së bashku me Frontex-in dhe ripranimin në territorin e saj të bashkëatdhetarëve). Rruga e largët drejt aderimit të Shqipërisë në BE ka një çmim: vendi duhet të plotësojë pritshmëritë në fushën e kontrollit të emigracionit, në dëm të respektimit të të drejtave themelore të emigrantëve dhe ndonjëherë dhe të të drejtave të shqiptarëve dhe shqiptarëve të saj.

Për më tepër informacion

Avokati Popullit, *Annual Report on the activity of People's Advocate, 2021*.

Balkans Refugee and Migration Council, *Common Western Balkan Migration Policy: Borders and Returns Regional Policy Paper II et III, 2020*.

Migreurop, *Exils sans fin – Chantages anti-migratoires le long de la route des Balkans, 2021*.

Sophie-Anne Bisiaux, Lorenz Naegeli, "Chantage dans les Balkans: comment l'UE externalise ses politiques d'asile", Migreurop, nëntor 2021.

La Cimade është një shoqatë solidarësie aktive ndaj emigrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve. Me partnerët e saj në Francë por dhe në Botë kjo shoqatë vepron për respektimin e të drejtave dhe të dinjitetit të njeriut që prej vitit 1939.

lacimade.org

Hartuar nga

La Cimade
91, rue Oberkampf
75011 Paris

Tel. +33 (0)1 44 18 60 50
infos@lacimade.org

www.lacimade.org

Një botim i koordinuar nga

Lydie Arbogast,
Hajer Ben Boubaker,
Eva Ottavy

Realizimi grafik Bureau 205

Dorëzuar zyrtarisht
Prill 2023

ISBN
978-2-900595-76-3



Me pjesëmarrjen

Anna Amiach,
Marion Beaufils,
Ana Marku,
Aude Millet,
Valentina Pacheco,
Elsa Putelat,
Camille Tournebize,
Anne-Sophie Wender

Përkthimi

Anglisht
KA-Lex Traduction
(Katherine Booth
dhe Alexandra
Poméon O'Neill)
Shqip
Ermelinda Muho

la Cimade

L'humanité passe par l'autre